



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 11.03.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 10 dhe 33 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe kërkesës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim të dt: 26.02.2015, për lejimin e pagesës së shpenzimeve të varrimit për tre qytetarë të Komunës së Gjakovës, e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim e dt: 26.02.2015 për lejimin e pagesës së faturave të KRM “Çabrati”, për shpenzimet e varrimit të tre qytetarëve të Komunës së Gjakovës, sipas të dhënave vijuese:

1. Fatura e KRM “Çabrati” nr.102/12/14 në vlerë prej 135.00€, në emër të shpenzimeve të transportit dhe varrimit të të ndjerit Homez Luboja.
2. Fatura e KRM “Çabrati” nr.102/01/15 në vlerë prej 115.00€, në emër të shpenzimeve të transportit dhe varrimit të të ndjerit Enver.H. Dobroshi.
3. Fatura e KRM “Çabrati” nr.44/15 në vlerë prej 135.00€, në emër të shpenzimeve të transportit dhe varrimit të të ndjerit Bedri Roka.

II. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerën totale prej 385.00€ nga subvencionet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, në emër të shërbimeve të kryera nga KRM “Çabrati”, për varrimin e tre qytetarëve të Komunës së Gjakovës, sipas shënimeve të përshkruara në pikën paraprake.

III. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 385.00€ nga subvencionet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirlogarinë e KRM “Çabrati” nr.1402000001765723-Banka Ekonomike.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

V. Vendimi iu dërgohet :

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- KRM “Çabrati”
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila